Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1054

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasasni - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE "Agron Halimi" B.I., kundër Njoftimit për kontratë ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet veterinare ne terren ne tere territorin e Republikës së Kosovës" me numër të prokurimit 40800-23-12612-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Agjencioni Veterinarisë dhe Ushqimit, më 20/02/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e "Agron Halimi" B.I. me nr. 2023/1054, e datës 26/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet veterinare ne terren ne tere territorin e R. Kosovës", me numër të prokurimit 40800-23-12612-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Agjencioni Veterinarisë dhe Ushqimit.

2. Mbetët në fuqi njoftimi për kontratë për aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.11.2023 Agjencioni Veterinarisë dhe Ushqimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Shërbimet veterinare ne terren ne tere territorin e R. Kosovës", me numër të prokurimit 40800-23-12612-2-1-1. Afati për dorëzimin e ofertave 27.12.2023 (nuk është bërë hapja e ofertave).

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 809.910.00 €.

Me 13.12.2023 OE “Agron Halimi” B.I ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 19.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me datën: 26.12.2023, OE “Agron Halimi B.I.”, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1054, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shërbimet veterinare ne terren ne tere territorin e Republikës Kosovës” me nr. të prokurimit: "40800-23-12612-2-1-1"

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: “Lidhur me pretendimin ankimor të OE se AK ka bërë shkeljen e Nenit 7 të LPP-së është i pabazë, sepse si AK kemi respektuar këtë nen dhe autoriteti kontraktues i ka trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe ka vepruar në mënyrë transparente. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. Në këtë rast në sistemin e e-prokurimit vërejmë që dosja e tenderit është shkarkuar shumë herë por që autoriteti kontraktues pas pranimit të opinionit nga Agjencia Kundër Korrupsionit kërkesa e cekura në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë gjegjësisht në pikat III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional të njoftimit për kontratë dhe Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pikat 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit Kërkesa 1. Operatoret ekonomik duhet të plotësojnë kriterin për veteriner të diplomuar dhe teknik të veterinarisë të diplomuar sipas numrit të fondit të krerëve të kafshëve e që janë ndarë në tre kategori Kategoria 1 komunat me mbi 20000 krerë kafshë - Prizrenit Lot 2, Ferizajt Lot 3 dhe Podujevës Lot 9 - duhet të kenë së paktën tre (3) veterinar dhe gjashtë (6) teknik të veterinarisë. Kategoria 2 komunat deri 20000 krerë kafshë - Mitrovicës Lot 1, Gjilanit Lot 4, Skenderajt Lot 5, Deçanit Lot 6, Vushtrrisë Lot 8 dhe Lipjanit Lot 12 duhet të kenë së paku dy (2) veterinar dhe katër (4) teknik të veterinarisë. Kategoria 3 komunat deri 10000 krerë kafshë - Fushë Kosovës Lot 7, Junikut Lot 10, Leposaviqit Lot 11, Obiliqit Lot 13, Zubin Potokut Lot 14, Zveçanit Lot 15, Ranillugut Lot 16, Parteshit Lot 17, Kllokotit Lot 18, Garancisë Lot 19 dhe Mamushes Lot 20 duhet të kenë së paku një (I) veterinar dhe dy (2) teknik të veterinarisë është larguar në tërësi dhe autoriteti kontraktues ka respektuar opinionin e dhënë dhe me formularin e ndryshimit korrigjimit të procedurës së prokurimit të bashkangjitur në sistemin e e-prokurimit si i publikuar këtë kërkesë e ka larguar në tërësi. Me kërkesë drejtuar A K AUV opinioni i AKK-së mund të ju dërgohet secilit operator ekonomik të interesuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE se AK ka bërë shkeljen e Nenit 52 të LPP-së është i pabazë, sepse si AK kemi respektuar këtë nen dhe kemi zhvilluar procedurën e prokurimit sipas nenit 52 paragrafi 1. Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret duhet të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm në rastin e kësaj procedure të prokurimit kriteri i

vendosur është tenderi me çmimin më të ulet i peshuar dhe sipas paragrafit 6. Të këtij neni ku ceket që Në rast të kriterit, tenderi me çmimin më të ulët nuk lejohet konvertimi i çmimeve në pikë dhe të peshohen pikët. Në rast të kontratave për shërbime të shumëfishta ose në rast të kontratave me çmime për njësi, çmimet mund të peshohen në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në rast të çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet, çmimet e peshuara bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm. Kështu që shërbimet janë ndarë në kategori sipas njësisë kërkuese dhe secilës kategori i është dhënë rëndësia e përqindjes. Si autoritet kontraktues presim nga operatoret ekonomik që të kenë kujdes gjatë përdorimit të termave si psh. në një fjali të kërkesës për rishqyrtim është përdorur ky termë "e jo sipas ligjit të Dautit (herë shërbimi e herë tabela)" sepse duhet të ju rikujtojmë operatorëve ekonomik që përdorin lloje të këtyre termave se në bazë të ligjit të prokurimit publik në të kaluarën janë shpërblye me kontratë dhe kanë kryer shërbimet në bazë të këtij ligji. Në baze të kësaj që u tha më lartë, AK-AUV konsideron se kërkesa për ri shqyrtim është në kundërshtim me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe AK AUV sipas nenit 108/A, paragrafi 10.1, refuzon kërkesën e propozuara për shqyrtim si të pabazë.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Agron Halimi B.I.” janë parashtruar si në vijim:

Në Aneksin 1 Specifikimet teknike të detyrueshme AK-AUV bazohet në Ligjin e Veterinës Nr. 21/2004 neni 31,32 dhe 33 si dhe udhëzimet administrative që Specifikimet teknike të detyrueshme si: realizimi i punëve në terren në mënyrë të qartë, të saktë dhe precize duhet të bëhet përmes praktikave veterinare të licencuara bazuar në udhëzimin administrativ MA-Nr. 22/2005 për licencimin e ambulancave, stacioneve dhe klinikave veterinare Neni 2 pika e,f,g,h,i, Neni 14 , Neni 4 pika 6,Neni 7 pika 9. Të respektoj në plotni dhe pa diskriminim ndaj një apo më shumë OE me secilën kërkesë edhe në Dosjen e Tenderit: Titulli i kontratës: Shërbimet veterinare në terren në tërë territorin e R. së Kosovës Nr. i prokurimit:40800-23-12612-2-2-1-1. Kjo diskriminon shërbimet veterinare të cilat në vazhdimësi për të marrë të drejtë (licencë) pune kanë paguar tatime dhe kanë qenë të obliguar sipas ligjit të mbajnë të punësuar së paku edhe dy teknikë të veterinarisë. Për të njëjtat shërbime në Maj të vitit 2023 Shërbimet veterinare ne terren ne tere territorin e R. Kosovës me nr. Prokurimi:40800-22-14128-2-1-1 janë kërkuar në Përshtatshmërinë profesionale dhe aftësinë profesionale së paku 3 veterinar dhe 6 teknik të veterinarisë me të drejtë pune ndërsa tani në grupin e Dytë prej 20 Komunave ndryshojnë kërkesat duke ia adaptuar një OE Kërkojmë vlerësim OSHP që Agjencioni Veterinarisë dhe Ushqimit të përcaktohet qartë që Specifikimet teknike të detyrueshme Aneksi 1 DT të bazohen në Ligjin e Veterinës Nr. 21/2004 dhe në udhëzimet administrative. Autoriteti kontraktues do t’i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Kërkojmë nga OSHP qe Autoriteti Kontraktues te veproje ne baze te nenit 28. Kjo kërkesë vjen ne shprehje pasi ka indikacione se AK po vepron ne favore te një operatori ekonomik duke u bazuar ne te kaluarën kur edhe është anuluar procedura pasiqe operatori i AK-se ishte jashtëzakonisht i papërgjegjshëm, ne kemi bere kërkesë për ri shqyrtim por AK duke shfrytëzuar kompetencat pa te drejte ka refuzuar kërkesën tone te bazuar me shume fakte dhe argumente e përpos kësaj AK ka anuluar procedurën e pare edhe pse ne Lotin qe i përkiste Komuna Ferizaj kishte OE te përgjegjshëm siç ishim ne, kjo ka ardhur vetëm e vetëm për ti hapur rruge për te dytën here Operatorit favorizues qe ti plotësojë kërkesat dhe kriteret e dosjes. AK po ashtu ka

heq te gjithë kriteret e mundshme qe kanë te bëjnë me Veterinarinë vetëm e vetëm ti jap mundësi OE te tyre ti plotësojë kushtet dhe specifikimet teknike. Kërkojmë nga OSHP për vlerësim të Dosjes së Tenderit me: Titulli i kontratës: Shërbimet veterinare në terren në tërë territorin e R. së Kosovës, Nr. i prokurimit:40800-23-12612-2-2-1-1. A është në përputhshmëri me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L092 në veçanti për Kriteret e dhënies së kontratës Neni 52. Të specifikojnë aneksin Përshkrimi i çmimeve- vlerësimi i kostos së shërbimit të ndahet në kategori me fusha të veçanta sipas rëndësisë nuk i futur në kalkulim edhe tabelat për kompensimet për paga, kostot fikse, kostot variabile dhe fitimet në rubrika të veçanta për secilin shërbim veç e veç. Nëse përdor variantin tenderi ekonomikisht më i favorshëm duke i peshuar çmimet atëherë të përcaktohet saktësisht për kategori apo shërbim të cilin e merr si bazë për kriter të dhënies së kontratës. Në vitin 2023 ne kemi rënë viktimë pikërisht e interpretimit të Kriterit të dhënies së Kontratës duke i dhënë Kontratë OE i cili Nuk i kishte plotësuar Kërkesat e përshtatshmërisë, Kapaciteti teknik dhe profesional dhe me peshim çmimi më të lartë në tabelë dhe në Kategori dhe duke e shpallur si Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të lirë dhe si tenderi i përgjegjshëm me kërkesa administrative. Kërkojmë nga OSHP për vlerësim, Kriteret e dhënies së kontratës së kësaj DT a janë në përputhje me LPP të lartcekura.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1054/2023, ndërsa me datë 11.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1054 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Lidhur me pretendimet e OE "Agron Halimi B.I", eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1054 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin e parë (I): Struktura e ankesës e përgatitur nga operatori ekonomik ankues nuk është e ndarë ne pretendime ankimor mirëpo për qëllime praktike te raportit te ekspertizës i kemi renditur pretendimet ankimore si ne vijim. Sipas pretendimit ankimor nr 1, AK ka shkelur nenin 7 te LPP-së Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi. Operatori ekonomik ankues nuk ka ofruar ndonjë dëshmi te caktuar se AK-gjatë përgatitjes se dosjes se tenderit ka kërkuar tek kriteret e përzgjedhjes ndonjë dokument i cili ja pa mundëson OE ankues pjesëmarrjen ne këtë aktivitet te prokurimit. Sipas nenit 51.3 Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse. Kërkesat minimale të kualifikimi, mund të përcaktohen nga AK kur AK konstaton se është e nevojshme për të siguruar që vetëm OE që posedojnë aftësi të caktuara profesionale, financiare ose teknike do të marrin pjesë në konkurrencë për kontratë. Sipas AK për ketë çështje kanë pranuar edhe opinion nga Agjencia Kundër Korrupsion dhe ndryshimet ne dosje te tenderit i kanë bërë në harmoni me opinionin e Agjencisë Kundër Korrupsion. Mbetet në përgjegjësin e

AK-së nëse i ka te harmonizuara kërkesat sipas opinionit te Agjencisë Kundër Korrupsion. Pasi qe kjo çështje është trajtuar edhe nga AKK ne nuk do te trajtojmë me tutje. Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne shkresat e lendes pretendimin e AK-së se ndryshimet ne dosje te tenderit janë bërë sipas opinionit te Agjencisë Kundër Korrupsion konstaton se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin e dytë (II): Sipas këtij pretendimi ankimor AK ka bërë shkelje te nenit 28 te Specifikimeve Teknike. Në ankesën e vetë OE ankues i referohet nenit 28 te Specifikimeve Teknike mirëpo tek kjo pikë me shumë e trajton çështjen e shkeljes tek kriteret e përzgjedhjes saktësisht te kritereve te përshtatshmërisë profesionale qe ndërlidhen me pretendimin ankimor nr 1. Sa i përket kërkesës se operatorit ekonomi ankues se "Kërkojmë vlerësim OSHP që AK të përcaktohet qartë që Specifikimet teknike të detyrueshme Aneksi 1 DT të bazohen në Ligjin e Veterinës Nr. 21/2004 dhe në udhëzimet administrative konstatojmë se shërbimet duhet te kryhen ne harmoni me Ligjin e Veterinës ashtu siç është cekur nga AK edhe ne pjesën e Aneks 1 tek Specifikimet Teknike. Pasi qe AK ka vendosur kritere te përzgjedhjes sipas opinionit te Agjencisë Kundër Korrupsion atëherë ne rolin e ekspertit shqyrtues me qellim te mos krijimit te paqartësive ne vendimmarrje nuk do te trajtojmë me tej ketë pretendim ankimor. Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne shkresat e lëndës, pretendimin ankimor te operatorit ekonomik ankues dosjen e tenderit konstaton se ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimi e tretë (III): Sipas këtij pretendimi ankimor AK ka bërë shkelje te nenit 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës. AK ka përdorur ne ketë aktivitet te prokurimit kriterin për dhënie kontrate "Çmimi me i lirë me poentim" Sipas nenit 52.6 te LPP-së dhe nenin 27.12 dhe 27.13 te Rregullores për Prokurim Publik 001/2022. Sipas nenit 52.6 , citat neni: Në rast të kontratave për shërbime të shumëfishta ose në rast të kontratave me çmime për njësi, çmimet mund të peshohen në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në rast të çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet, çmimet e peshuara bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm. Ne dosje te tenderit tek Aneks 6 Kriteret për Dhënie Kontrate , AK ka vendosur kriterin "Çmimi më i ulët i peshuar" duke ndarë kategoritë e shërbimeve tek përshkrimi i çmimeve ne tri kategori Pjesa A.B.C. Vlen te theksohet se është në përgjegjësin e Autoritetit Kontraktues ndarja e shërbimeve dhe poentimi i tyre ne raport me vlerën e planifikuar te shërbimeve për secilën kategori ne mënyrë qe te arrihet funksioni i peshimit sipas nenit 27.14 , citat neni "27.14 Funksioni i vetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet në baze të çmimit të ofertuar". Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne shkresat e lendes, dosjen e tenderit , nenin 52.6 te LPP-së, neni 27 paragrafët 12,13,14 te Rregullores për Prokurim Publik 01/2022, konstaton se pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues, është i pa bazuar. Bazuar ne përshkrimin e bërë me sipër sipas shkresave te lëndës, dosjes se tenderit, opinionin e Agjencisë Kundër Korrupsion, eksperti shqyrtues rekomandon panelin shqyrtues te mbetet ne fuqi njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit, AK, te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit sipas LPP-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje lidhur me raportin e ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr

parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit.

PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet te jenë padrejtësisht te rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme te cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim. Rrjedhimisht paneli shqyrtues e mbështetet raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues të caktuar nga OSHP, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe mendimi i tij i cili supozohet të jetë profesional e ka mbështetur me arsyeshmëri ligjore dhe ka ardhur deri te një konstatim konkret se nuk ka diskriminim nga ana e AK dhe kërkesat janë të bazuara me ligj.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron se AK në këtë rast në bazë të rekomandimeve të ekspertit ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenet 7, 27 të LPP. Andaj, kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, pa fakte dhe prova dhe/ose pa bazë ligjore, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse. Po ashtu, të gjitha AK janë të obliguara që hartimi i DT dhe specifikimeve teknike të jetë konform nenin 27 dhe 28 të LPP.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT**
- OE - **Agron Halimi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: